



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
ADMINISTRATORI

Nr. 1239/Prot.
7

Durrës, më 16/12/2022.

FTESË PËR TENDER
" PËR BLERJEN DHE KRIJIMIN E PAKETAVE SOFTWARE PËR PROJEKTIN
STAND NË KUADËR TË PROGRAMIT ERASMUS+ "

Drejtuar: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIK TË INTERESUAR PËR TË
MARRË PJESË

Publikuar në website-n e Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës - www.uamd.edu.al

Referimi ynë: Urdhër Blerje me Nr. 558., datë 16.12.2022 me Nr.1239/5 Prot datë 16.12.2022

Subjekti: Ftesë për ofertë me objekt: "Blerje dhe krijim paketa software për projektin STAND, në kuadër të programit Erasmus+".

Të nderuar Zonja, Zotërinj,

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës në zbatim të projektit financiar në kuadër të programit ERASMUS+" Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkans Universities (STAND), bazuar në Marrëveshjen e Grantit (Grant Agreement for an Action With Multiple Beneficiaries under "Erasmus + Capacity Building in the Field of Higher Education" me Nr. Ref 618805- EPP-1-2020 -1 -XK – EPPKA2 – CBHE – SP, Marrëveshjes së Bashkëpunimit (Partnership Agreement) me Nr. 177/12/20 Prot datë 02.12.2022 të nënshkruar me International Business College Mitrovica , në parashikimet e udhëzuesit sipas versionit të fundit (Guidelines for the Use of Grant CBHE 2021) si dhe Urdhërit të blerjes me Nr. 558 datë 16.12.2022 me Nr.1239/5 Prot datë 16.12.2022, ju fton të parasiqni ofertën tuaj me objekt: "Blerje dhe krijim paketa software për projektin STAND, në kuadër të programit Erasmus+ sipas preventivit të mëposhtëm dhe specifikimeve teknike bashkëlidhur:

Nr.	Emërtimi	Sasia
1.	Ndërtimi i modulit të burimeve njerëzore, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1
2.	Ndërtimi i modulit të kalendarit akademik, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1
3.	Ndërtimi i modulit të programit akademik, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1

Buxheti:

Fondi limit i parashikuar është 31, 800 (tridhjetë e një mijë e tetëqind) Euro Pa TVSH.

Vendi dhe data e dorëzimit të ofertës :

Data e dorëzimit të ofertës, do të jetë datë 27.12.2022, deri në ora 11:00, në zarfa të mbyllur të vulosur e firmosur me shënimin për projektin për të cilin ofertojnë, në adresën Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës , Lagjia Nr.1 Rruga e Currilave Durrës , kati 3 Protokolli.

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur me shënimin “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____ orës _____”, duke specifikuar projektin, objektin e shërbimit për të cilin paraqet ofertën ekonomike, pranë autoritetit kontraktor me protokoll, jo më vonë se data dhe ora e caktuar, si dhe dokumentacionin si më poshtë (sipas shtojcave bashkëlidhur):

1. Kriteret e përjashtimit/ Exclusion criteria:

Tenderuesit duhet të vërtetojnë se nuk janë në një nga situatat e renditura më poshtë duke plotësuar formularin vetpërmbledhës të deklaramentit sipas percaktimeve si më poshtë :

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Edhe ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.
- Në cdo rast Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e Informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

2. Kriteret e përzgjedhjes/ Selection criteria

Data e dorëzimit të ofertës, do të jetë datë 27.12.2022, deri në ora 11:00, në zarfa të mbyllur të vulosur e firmosur me shënimin për projektin për të cilin ofertojnë, në adresën Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës , Lagjia Nr.1 Rruga e Currilave Durrës , kati 3 Protokolli.

Operatori ekonomik duhet të dorëzojë në një zarf të mbyllur me shënimin “MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËM KOMISIONI I VLERËSIMIT TË OFERTËS, DHE JO PARA dd/mm/vv _____

orës _____“, duke specifikuar projektin, objektin e shërbimit për të cilin paraqet ofertën ekonomike, pranë autoritetit kontraktor me protokolll, jo më vonë se data dhe ora e caktuar, dokumentacionin si më poshtë dhe sipas shtojcave bashkëlidhur :

1. Formularin e ofertës ekonomike sipas shtojcës 1 bashkëlidhur;
2. Deklaratë mbi konfliktin e interesit sipas shtojcës 2 bashkëlidhur;
3. Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme sipas shtojcës 3 bashkëlidhur;
4. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të ekzekutimit, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur;
5. Ekstrakti mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit të Biznesit (QKB), i cili duhet të përfshijë objektin ose ekuivalentin e objektit të prokurimit, lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
6. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore gjatë 3 viteve të fundit ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të përlogaritur;
7. Operatori ekonomik duhet të ketë një numër prej mesatarisht 3 (tre) punonjës të siguruar, ku përfshihet 1 (një) personel teknik që do të angazhohet në zhvillimin e programeve kompjuterike:
 - a) Të paktën 1 (një) specialist programues “Senior”, të çertifikuar në nivel “Professional” MCSD, ose ekuivalent.
 - b) Të paktën 2 (dy) specialistë programues “Junior” të çertifikuar në nivel “Associate” MCSA, ose ekuivalent

Për të vërtetuar stafin e mësipërm operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Deklaratë për stafin përgjegjës
 - Certifikata përkatëse/ Transkriptet përkatëse ose ekuivalente.
 - Listëpagesat e shoqërisë për periudhën Nëntor 2022. Për këtë duhet të dorëzohen listëpagesat sipas formatit E-Sig 025/a.
8. Per autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumentave të tilla si çertifikata ISO ku operatori ekonomik duhet të deshmojë se është i paisur me certifikatat:
- **ISO 9001:2015 - Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalente**, (e vlefshme) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe

standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;

Dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

3 . Kriteri i vlerësimit/Evaluation criteria:

Oferta fituese do të bazohet në parimin e ofertës me çmimin më të ulët.

- Cmimi me i ulët i ofertës së përgjegjeshme.
- Ku nevojiten jo më pak se 3 oferta të vlefshme nga 3 operatorë të ndryshëm.

Afati i realizimit : do të jetë 4 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Vlefshmëria e tenderit/ Tender validity:

Tenderi është i vlefshëm për një periudhë prej 3 muajsh pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave.


Në rrethana të jashtëzakonshme, autoriteti kontraktor mund, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë, të kërkojë që tenderuesit të zgjasin vlefshmërinë e ofertave për një periudhë specifike.

Gjuha e tenderit/ Tender Language:

Oferta e tenderit dorëzohet në shqip ose anglisht. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe ose angleze. Ofertat e tenderit të paraqitura në ndonjë gjuhë tjetër do të refuzohen automatikisht.

ADMINISTRATOR

Gerald ÇEKI



SPECIFIKIME TEKNIKE DHE SASIA E KËRKUAR

ERASMUS+“ Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkans Universities (STAND) me Nr. Ref 618805- EPP-1-2020 -1 – XK – EPPKA2 – CBHE – SP,

Objekti: “Blerje dhe krijim paketa software për projektin STAND, në kuadër të programit Erasmus+.”

1. Përfituesi/ Autoriteti Kontraktues

Përfituesi: Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD)

1.1 Historiku

Në formën e tij moderne Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës celi dyert për herë të parë në vitin akademik 2006-2007 me rreth një mijë studentë nga i gjithë vendi. Me hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës nuk ishte për qëllim hapja e një Institucioni të ri në vend, por hapja e një Institucioni ndryshe, i cili do të sillte eksperiencat më të mira akademike perëndimore.

Filozofia e punës në UAMD është “ studentit në qendër të vemendjes”, që do të thotë se gjithcka që ndodh në Universitet që nga procesi mësimor , shërbimet, aktivitetet dhe mjetet janë në shërbim të studentit . Kjo bëhet e mundur nëpërmjet një stafi dinamik të zgjedhur dhe të përkushtuar.

Mënyra e zhvillimit të procesit mësimor, procedurat e kontrollit të dijës, rekrutimi i stafit akademik, këshillimi i studentëve, shërbimi i bibliotekës universitare dhe kërkimi shkencor kanë si qëllim realizimin e një përvoja akademike unike në vend, që nuk përjashton asnjë element domethënës të Universiteteve Evropiane dhe atyre Amerikane.

Sot Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës ka 5 fakultete : Fakulteti i Biznesit , Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Shkencave Politike- Juridike dhe Fakulteti i Studimeve Profesionale. Në këto fakultete numërohet rreth 20 mijë studentë në të tre ciklet e studimit.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objekti kryesor i këtij shërbimi është ndërtimi i një programi për përdorim nga UAMD i cili duhet të ketë modulet e mëposhtme:

- Moduli i burimeve njerëzore
- Moduli i kalendarit akademik
- Moduli i programit akademik

Këto module duhet të krijohen dhe të integrohen në infrastrukturën aktuale të UAMD.

2.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktohen funksionalitetet dhe teknologjia e programit të administrimit të burimeve njerëzore kalendarit akademik dhe programit akademik të UAMD.

Programi duhet të konsistojnë në:

- **Ndërtimin e modulit të burimeve njerëzore.**
Moduli i burimeve njerëzore duhet të mundësojë përdoruesin që të krijojë kartela të secilit punonjës, të ngarkojë CV-e tij, dokumentat shoqëruese sipas kodit të punës dhe raportet mjekësore. Në këtë mënyrë mundësohet ndërtimi i një regjistri elektronik të punonjësve të UAMD dhe dokumentacionit shoqërues. Moduli duhet të mundësojë gjithashtu llogaritjen e pagës sipas legjislacionit në fuqi për secilin burim;
- **Ndërtimin e modulit të kalendarit akademik.**
Moduli i kalendarit akademik duhet të mundësojë administratorin që të përcaktojë data e ngjarjeve të ndryshme si pushime, rekrutime apo regjistrime. Kalendarit nuk duhet të lejojë mbivendosje për të njëjtin person. Administratori duhet të ketë mundësi të vendosë shënime për secilën ngjarje që regjistron;
- **Ndërtimin e modulit të programit akademik.**
Moduli i programit akademik duhet të mundësojë administratorin të ndërtojë programe akademike në mënyrë modulare duke shtuar apo hequr lëndë. Për secilën lëndë duhet të ketë mundësi të përcaktojë detajet e saj si dhe kreditet. E njëjta lëndë mund të lidhet me disa programe akademike.

2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktori

Operatori ekonomik fitues duhet të realizojë programin kompjuterik të administrimit të UAMD me modulet përkatëse duke:

- Krijuar çdo modul si pjesë të një sistemi ueb i cili të mundësojë përdoruesin të aksesojë sistemin nëpërmjet një shfletuesi të lidhur në Internet qoftë Google Chrome apo Mozilla Firefox.
- Përdorur një arkitekturë modulare dhe një databazë të normalizuar për të lehtësuar shtimin e funksionaliteteve në të ardhmen.
- Aplikuar praktika të mira sigurie.
- Krijuar një ndërfaqe përdoruesi që të jetë aplikacion i mirëfilltë në Javascript.
- Ofruar optimizim të ndërfaqeve dhe moduleve në nivel ndërveprimi midis moduleve të krijuara.
- Ofruar trajnimin e përdoruesve të moduleve

Programi që do të implementohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit Nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, të ndryshuar, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

- Staf i autoriteti kontraktor, operatorit ekonomik dhe përfituesit të jenë të pavarur në punën e tyre dhe të gjendshëm në çdo rast.
- Staf i autoriteti kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik duhet të jenë komunikues dhe bashkëpunues me njëri-tjetrin.
- Staf i autoriteti kontraktor, përfituesit dhe operatorit ekonomik të jetë i aftë të gjejë konsensusin në rastet kur kërkohet.
- Informacioni i shkëmbyer midis stafit të palëve mbetet konfidencial mes palëve.

3.2. Risqet

- Vonesë në zbatimin e projektit si pasojë e mos koordinimit të punës mes stafit të përfshirë.
- Eksperienca e stafit të operatorit ekonomik fitues në projekte të tilla.
- Ndryshime të mundshme në formën e ndarjes aktuale administrative.
- Dokumentimi jo i mirë i sistemit elektronik dhe situatës aktuale të përshkruar.
- Mos respektimi i afateve kohore nga operatori ekonomik.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore në të cilën mbështetet projekti, si dhe duhet t'i përmbahet projekti është si më poshtë:

- Ligji Nr. 80/2015 “ Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Statuti dhe Rregulloret e UAMD.
- Të garantohet siguria dhe konfidencialiteti i të dhënave personale në respektim të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në vecanti të nenit 27 “ Masat e sigurisë për të dhënat personale” dhe nenit 28 “ Konfidencialiteti i të dhënave” të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Ligjin Nr. 10325 datë 23.09.2010 “ Për bazat e të dhënave Shtetërore”;
- VKM Nr. 945 datë 02.11.2012 për miratimin e rregullores “ Administrimi i sistemit të bazave të të dhënave shtetërore”.

4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Detyra kryesore e operatorit ekonomik të këtij shërbimi është ndërtimi i një programi kompjuterik për përdorim nga UAMD i cili duhet të ketë modulet e mëposhtme:

- Moduli i burimeve njerëzore
- Moduli i kalendarit akademik
- Moduli i programit akademik

Këto module duhet të krijohen dhe të integrohen në infrastrukturën aktuale të UAMD.

4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës

4.1.3 Grupet e synuara

Stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët e UAMD.

4.1.4 Siguria e sistemit

Siguria e sistemit duhet të jetë e bazuar në praktikat më të mira të sigurisë duke ofruar emër përdoruesi dhe fjalëkalim, të cilat duhet të jenë të ndara sipas roleve të përdoruesve.

Siguria mbështetet mbi atributet Besueshmëri, Integritet dhe Disponueshmëri. Siguria e software, duke ju referuar VKM Nr. 945, Datë 02.11.2012, “Per Miratimin e Rregullores “Administrimi i sistemit te bazave të të dhënave shtetërore”, sistemi duhet te jetë i nivelit të sigurisë M-D1I2K0 që do të thotë: M për siguri të mesme, D1 për disponueshmeri 90% me maksimumin e shkëputjes së aksesit 24 orë në javë, I2 për integritet të mesëm, K1 për informacion publik.

Për programin e administrimit të UAMD dhe modulet e tij do të përdoret një implementim në disa nivele sigurie:

- Programi duhet të suportojë kontrolle gjithëpërfshirëse të fjalëkalimeve si: fjalëkalimet duhet të jenë minimum me 8 karaktere, bllokimin e një përdoruesi pas pesë tentativave të dështuara për tu futur ne sistem, mbarimit të afatit të fjalëkalimit, historikun e fjalëkalimeve në mënyrë që fjalëkalimi aktual të mos jetë njësoj me fjalëkalimet e mëparshme etj;
- Programi duhet të mundësojë raporte për përpjekjet e dështuara për tu loguar në sistem nga përdorues të ndryshëm;
- Sistemi duhet të ketë të gjitha funksionet e nevojshme për administrimin shërbimeve dhe të roleve të përdoruesve. Më poshtë po paraqesim disa nga rolet dhe funksionet përkatëse:
 - o Administrator i përgjithshëm – me akses total në çdo veprimtari të sistemit;
 - o Menaxher Raportesh (klasifikim sipas tipit të raporteve) – Krijim, ndryshim dhe fshirje raportesh;
 - o Editor – Roli kryesor në editimin e të dhënave, konfirmim ndryshimesh etj;
 - o Përdorues – Roli që ka mundësinë për të bërë ndryshime të pa aprovuara në lokalitetin e përcaktuar;
 - o Vizitor – vetëm shikim të dhënash

Me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë së informacionit programi që do të krijohet nevojitet që baza e të dhënave të administruara në këtë të fundit të jetë e enkriptuar. Enkriptimi i bazës së të dhënave duhet të jetë i specifikimit AES (Advanced Encryption Standard) 256 bit.

Qëllimi i enkriptimit të të dhënave brenda bazës së të dhënave është ruajtja nga qëllimet dashakeqe dhe keqpërdorimet e tyre.

4.2. Detyrat specifike

Kontraktori ka si detyrë realizimin e projektit duke kaluar nëpër disa faza kryesore:

Faza I: Analizimi i kërkesave, sistemit ekzistues dhe bazës ligjore. Kjo fazë është faza përgatitore ku operatori ekonomik fitues duhet të bëjë një analizë të plotë të të gjitha procedurave administrative dhe ligjore dhe do të konceptojë mënyrën e zgjidhjes.

Faza II: Ndërtimi i programit kompjuterik dhe moduleve. Në këtë fazë fillon ndërtimi i programit dhe moduleve specifike duke zhvilluar kërkesat e nevojshme.

Faza III: Testimi i programit të krijuar dhe moduleve përkatëse, trajnimi i stafit për përmirësimet e bëra dhe marrja në dorëzim e tij. Kur çdo gjë të jetë gati për punë do të bëhet testimi i sistemit të përmirësuar, trajnimi i stafit dhe marrja në ngarkim e tij.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Vendndodhja do të jetë në infrastrukturën IT të UAMD

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Si datë fillimi e projektit do të merret “Data e nënshkrimit të kontratës” dhe periudha e implementimit do të jetë 4 (katër) muaj nisur nga kjo datë.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip, në original dhe 2 (dy) kopje:

- Raporti Fillestar prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet brenda 5 ditësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruajë p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar
- Drafti i raportit përfundimtar i përbërë prej maksimumi 20 (njëzet) faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset) Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së implementimit të detyrave.
- Raporti final me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 5 (pesë) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të

përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Programi që do të krijohet duhet të mundësojë ekspozimin e të dhënave parësore data bazës së tij në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit.

8. GARANCIA

Garancia e programit të ndërtuar dhe moduleve të tyre, duke përfshirë dhe suportin teknik mirëmbajtjen e tyre do të jetë për një periudhë me afat kohor **1 (një) vit**.

9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Ndërtimi i modulit të burimeve njerëzore, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1		
2.	Ndërtimi i modulit të kalendarit akademik, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1		
3.	Ndërtimi i modulit të programit akademik, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1		
TOTALI PA TVSH (LEKË)				

10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6
1	Faza I – Analizimi i situatës aktuale	X					
2	Faza II – Ndërtimi i programit dhe moduleve përkatëse	X	X	X			
3	Faza III – Integrimi, testimi i moduleve dhe trajnimi i përdoruesve.			X			
4	Marrja në dorëzim				X		

11. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Të gjitha të drejtat mbi kodin burim dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të aplikacionit apo pajisjeve, skica, etj.) do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor. Zgjidhja do të dorëzohet e shoqëruar me kodin burim të strukturuar dhe të komentuar, për çdo modul dhe për sistemin në tërësi, së bashku me setin e dokumentacionit teknik. Kodi burim duhet të dorëzohet i plote pas implementimit të sistemit dhe i azhurnuar sa herë që mund të bëhen ndryshime gjatë fazës së mirëmbajtjes, në fund të kësaj periudhe.

12. KERKESAT FUNKSIONALE

Duke u nisur nga një plan përmirësimi i nxjerrë nga analiza e mësipërme po bëjmë një listim të kërkesave funksionale të organizuara në modulet përkatëse të cilat përcaktojnë në një farë mënyre edhe arkitekturën e sistemit e cila është në vetvete një kërkesë e nevojshme për përmirësim.

1. Moduli i Burimeve Njerëzore.

Moduli i burimeve njerëzore duhet të mundësojë përdoruesin që të krijojë kartela të secilit punonjës, të ngarkojë CV-e tij, dokumentet shoqëruese sipas legjislacionit në fuqi dhe raportet mjekësore. Në këtë mënyrë mundësohet ndërtimi i një regjistri elektronik të punonjësve të UAMD dhe dokumentacionit shoqëruës. Moduli duhet të mundësojë gjithashtu llogaritjen e pagës sipas legjislacionit në fuqi.

2. Moduli i Kalendarit Akademik

Moduli i kalendarit akademik duhet të mundësojë administrimin dhe shfaqjen e ngjarjeve të ndryshme si pushime, rekrutime, regjistrime apo sezon. Administratori duhet të ketë shënime për secilën ngjarje që regjistron.

3. Moduli i Programit Akademik

Moduli i programit akademik duhet të mundësojë administratorin të ndërtojë programe akademike në mënyrë modulare duke shtuar apo hequr lëndë. Për secilën lëndë duhet të ketë mundësi të përcaktojë detajet e saj si dhe kreditet. E njëjta lëndë mund të lidhet me disa programe akademike.

Afati i lëvrimit : Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 4 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës sipas grafikut kohor të implementimit të sistemit.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

- Operatori ekonomik duhet të garantoj furnizimin, konfigurimin e sistemit, si dhe trajnimin e stafit përkatës.
- Operatori ekonomik duhet të garantoj mirëmbajtjen e sistemit për një periudhë 1-vjeçare.
- Gjithashtu operatori ekonomik duhet të garantoj se çdo e drejtë mbi kodin burim apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me sistemin e ri të ndërtuar nga operatori ekonomik duhet t'i kalojë përfituesit , autoritetit kontraktor në format elektronik.

Të gjitha këto të kryhen me stafin e Operatorit Ekonomik fitues dhe brenda vlerës së ofertuar.

Shtojca 1

Datë ___/___/2022.

FORMULARI I OFERTËS

Emri i Ofertuesit _____

Për: **Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje dhe krijim paketa software për projektin STAND, në kuadër të programit Erasmus+”

* * *

ERASMUS+“ Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkans Universities (STAND) me Nr. Ref 618805- EPP-1-2020 -1 – XK – EPPKA2 – CBHE – SP,

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) Euro pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) Euro me TVSH.

Nr.	Emërtimi	Sasia	Çmimi	Shuma (Lekë pa TVSH)
1.	Ndërtimi i modulit të burimeve njerëzore, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1		
2.	Ndërtimi i modulit të kalendarit akademik, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1		
3.	Ndërtimi i modulit të programit akademik, integrimi, trajnimi i përdoruesve	1		
TOTALI PA TVSH (LEKË)				

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim:

Të dhënat financiare që do të sigurohen nga Tenderuesi/Kandidati në formularin e ofertës duhet të shprehen në Euro. Nëse Tenderuesi/Kandidati i referohet shumave të shprehura fillimisht në një valutë tjetër (lek), konvertimi në Euro do të bëhet në përputhje me kursin e

këmbimit InforEuro të së cilës mund të gjendet në adresën vijuese:
<http://ec.europa.eu/budget/graphs/inforeuro.html>.

Shtojca 2

DEKLARATË Mbi konfliktin e interesave

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor Universiteti Aleksander Moisiu, Durrës me objekt “Blerje dhe krijim paketa software për projektin STAND, në kuadër të programit Erasmus+” me fond limit 31, 800 (tridhjetë e një mijë e tetëqind) Euro Pa TVSH.

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejta ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejta ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula _____

Shtojca 3

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor Universiteti Aleksander Moisiu, Durres me objekt “Blerje dhe krijim paketa software për projektin STAND, në kuadër të programit Erasmus+” me fond limit 31, 800 (tridhjetë e një mijë e tetëqind) Euro Pa TVSH.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale.

nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës: _____

Emri , Mbiemri, Nënshkrimi, Vula:

Shtojca 4

**DEKLARATË MBI PERMBUSHJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
REALIZIMIN E OBJEKTIT SIPAS GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me çertifikata e dokumenta (nëse kërkohen nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë, si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit _____

Nënshkrimi _____

Vula _____